BASHKIA M...
Zyra e Prot...
Nr.5235 Prot.....
Data 13.11.24 Nënshkrimi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
DREJTORIA VENDORE KORÇË

Nr.3188/7 Prot. Korçë, më 11.11.2024

Lënda: Kërkesë për publikim.

NJËSISË ADMINISTRATIVE VRESHTAS

Brenda kompetencave institucionale dhe tagrit ligjor të garantuar nga Ligji nr.111/2018 „ *Për Kadastrën*“, Ligjit nr. 20 dt.05.03.2020 *"Për përfundimin e proçeseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë"* dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1040/2020 " *Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kritereve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje*" Drejtoria Vendore e ASHK-së Korçë ka miratuar Vendimet për legalizimin e ndërtimeve pa leje në favor të subjekteve të poshtëshënuar.

Në zbatim të pikës 31 dhe 32 të VKM-së 1040/2020 ku parashikohet që " Lista e subjekteve përfituese të ndërtimeve të legalizuara, shoqëruar me të dhënat e pasurive, si adresa , zona kadastrale, numri i pasurisë publikohet në ambientet e ASHK-së, pranë njësisë së vetqeverisjes vendore, si dhe në faqen zyrtare të internetit të ASHK-së" dhe " Subjektet e interesuara në përputhje me afatet e përcaktuara në dispozitat e Kodit të Proçedurave Administrative, kanë të drejtë të paraqesin ankim administrativ për vendimin e legalizimit , pranë strukturës së posaçme të ankimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së", për sa më sipër kërkojmë:

- ***Publikimin për afatin 30 (tridhjetë) ditor në ambientet e Institucionit tuaj së listës së mëposhtme të subjekteve përfituese të ndërtimeve të legalizuara.***

- ***Çdo subjekt i cili ka pretendim apo ankesë në lidhje me vendimin e legalizimit është i lutur ti drejtohet strukturës së posaçme të ankimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së.***

- ***Në përfundim të afatit jeni të lutur të konfirmoni nëse ka apo jo kërkesë/ankesa nga subjektet.***

Bashkëngjitur shkresës po ju vemë në dispozicion:
- Tabelën me listën emërore të subjekteve përfituese ku janë të përcaktuara të dhënat e pasurisë.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

DREJTORI

Stavri Mushka

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria Vendore Korçë
Date:2024/11/11 13:05:41 +02'00'
10GeKORCE20241111113053489014

Adresa: Rr.1 Maji, Lagjia 18 , Korçë , www.ashk.gov.al, email: info@ashk.gov.al

240

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria Vendore Korçë)

Dt 13.11.2024